



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 228 prot.

Tiranë më 29.01.2018

**REKOMANDIM**

Nr. 01, datë 29.01.2018

**MBI**

**ZBATJMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44 datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 314, datë 14.12.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. Kontrolluesi Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit përpunon të dhëna personale të qytetarëve që regjistrohen në portalin unik qeveritar e-Albania. Ky portal ofron shërbime elektronike nga institucionet publike në Shqipëri. Portali e-Albania është i lidhur me "Platformën Qeveritare të Ndërveprimit", e cila është arkitektura bazë mbi të cilën mundësohet ndërveprimi me sistemet elektronike të institucioneve publike. Portali ofron informacion të detajuar në lidhje me shërbimet për publikun, (licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime të tjera të ngjashme), dokumentacionin e

nevojshëm, procedurën që duhet ndjekur, oraret e funksionimit, kontaktet etj. AKSHI në zbatim të VKM-së nr.673, datë 22.11.2017, "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe portalin unik qeveritar e-Albania. Marrja e shërbimeve publike të qeverisjes elektronike nëpërmjet portalit qeveritar nga çdo përdorues (qytetar), kalon në procesin e autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesit me qëllim garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në ofrimin e shërbimeve individuale. Autentifikimi dhe identifikimi në portalin qeveritar e-Albania, realizohet nëpërmjet sistemit të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore që koordinohet nga AKSHI. Procesi fillestar i regjistrimit kryhet nëpërmjet portalit qeveritar dhe të dhënat e plotësuara nga qytetarët gjatë procesit të regjistrimit, verifikohen në kohë reale elektronikisht me të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

2. Në lidhje me ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit rezulton se nga llogaria e ankuesit në portalin e-Albania nuk janë aksesuar ose printuar dokumente që përmbajnë të dhëna personale. Kjo vërtetohet nga gjurmët/loqet e gjeneruara nga sistemi si dhe nga llogaria ankuesit brenda portalit në ndërfaqen "Hapësira ime – Shërbimet e mia", ku gjendet lista e e-Shërbimeve të cilat janë përdorur më parë.

3. Nga verifikimi i kryer në portalin e-Albania rezultoi se nëpërmjet kërkesave aktuale për regjistrimin (rubrika Regjistrohu – Të dhënat e përdoruesit) ofrohen garanci të mjaftueshme, por që mund dhe duhet të japin garanci maksimale për autentifikimin e subjekteve të të dhënave (verifikimin e identitetit të përdoruesit), për të mos cenuar në asnjë rast, sigurinë e të dhënave personale.

Përfaqësuesit e kontrolluesit parashtuan se lidhur me problematikën e paraqitur nga ankuesi, në fillimet e funksionimit të Portalit, ka ekzistuar mundësia për të regjistruar përdorues të ndryshëm duke përdorur të njëjtin numër celulari/adresë email (psh. regjistrimet e maturantëve nga mësuesit për maturën shtetërore). Në të tilla raste ankesash, kontrolluesi ndryshon fjalëkalimin e regjistrimit fillestar, duke i dhënë mundësinë qytetarit që pas konfirmimit të identitetit të vendos të dhëna të tjera për të aksesuar përsëri profilin e tij. Nga komunikimet e vëna në dispozicion, një praktikë e tillë është ndjekur edhe në rastin e ankuesit.

Kontrolluesi në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, konsiderohet si një kontrollues i rëndësishëm, për shkak të sasisë së konsiderueshme të informacionit që përpunon. Numri i madh i shërbimeve të ofruara dhe ndërveprimi me bazat e të dhënave të institucioneve të tjera e bëjnë akoma të ndjeshme rëndësinë e respektimit të rregullave të mbrojtjes së të dhënave si përsa i përket ligjshmërisë së përpunimit, sasisë së informacionit të përpunuar dhe rregullave të sigurisë në ruajtjen e konfidencialitetit.

Kontrolluesi duhet të ndërmarr masa të përshtatshme teknike dhe organizative, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrimi aksidental apo i paligjshëm, modifikimi, përhapja apo aksesimi i paautorizuar, sidomos aty ku përpunimi përfshin transmetimin e të



dhënave në një rrjet dhe nga format e tjera të paligjshme të përpunimit. Një nga standartet kryesore të sigurisë së të dhënave është konfidencialiteti, duke siguruar që të dhënat të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar. Në këtë kontekst, autentifikimi i përdoruesve që regjistrohen për herë të parë në portal është faktor i rëndësishëm kundër cënimit të sigurisë së të dhënave personale.

Kontrolluesi duhet të ketë në vëmendje përdorimin e standardeve të sigurisë dhe përcaktimin e metodave të tjera dhe mjeteve për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Udhëzimin nr. 21 të Komisionerit. "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj". Pjesë e këtij Udhëzimi është dhe analiza e riskut, në të cilën identifikohen kërcënimet që prekin pjesë individuale të sistemit, siç është procesi i regjistrimit në portal, duke përcaktuar në fund një listë të kërcënimeve që mund të rrezikojnë konfidencialitetin e të dhënave personale të përpunuara si dhe propozimet e masave për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të këtij rreziku. Masat për përmirësimin e nivelit të sigurisë së kontrolluesit përfshijnë dhe instrumente të tilla sikurse është dhe certifikimi i pajtueshmërisë së tij me standartet teknike të sigurisë.

Gjithashtu, në referim të zhvillimeve të legjislacionit evropian dhe më konkretisht Rregullores 2016/679 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit (GDPR), datë 27 Prill 2016 , sugjerohet përfshirja e instrumenteve të tilla si certifikimi i sistemeve informatike me standartet evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Siguria e të dhënave nuk arrihet vetëm duke patur pajisjet e duhura elektronike dhe programet kompjuterike, por është e domosdoshme në të njëjtën kohë, të ketë edhe rregulla organizative të brendshme të tilla si, trajnimi i rregullt i punonjësve në lidhje me rregullat e sigurisë së mbrojtjes së të dhënave dhe detyrimeve të tyre sipas legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave, shpërndarje e lartë e përgjegjësive dhe përcaktimi i qartë i kompetencave etj.

Lidhur me konstatimet e evidentuara nga hetimi administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e kontrolluesit për të marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative të përshtatshme veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, sipas parashikimit në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 27, 29, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmirësimin e masave të sigurisë në drejtim të garantimit të procesit të autentifikimit të qytetarëve në portalin e-Albania, për të

shmangur çdo mundësi keqpërdorimi të të dhënave personale të një subjekti të dhënash përmes një regjistrimi të paautorizuar në portal.

2. Kontrolluesi Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmirësimin e vazhdueshëm të masave teknike dhe organizative për të garantuar përpunimin e sigurt të të dhënave personale gjatë ofrimit të shërbimeve.
3. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 29/01/2018

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

